



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 10, datë 30.03.2020

Për miratimin e Progres Raportit të ecurisë së punës të auditimit të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 2017 – 2019

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të nenit 18, pika 4 “Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6, si dhe të nenit 18 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, me propozim të Audituesit të Brendshëm të kontraktuar “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k”, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Progres Raportit të ecurisë së punës të auditimit të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për periudhën 2017-2019, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar